



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060104-44556 dt. 09/10/ 2025

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.09.2025, e cila filloi në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi Bekim Lestrani-kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Malësore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Hamit Kastrati (PDK).

Mungoi: Florentina Elezi-Veliu (VV).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Agnesa Bucolli- drejtoreshë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Endrit Gllareva, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës, Kushtrim Bajraktari zyrtar kryesor financiar .

Mbledhja pati këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 21.07.2025;
2. Draft buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe theksoi edhe për një pikë shtesë: **Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së, për vitin 2024.** Po ashtu në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, konkretisht nenin 36, i cili përcakton numrin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në bazë të numrit të banorëve, ju njoftojmë se në Komunën e Drenasit ka ndodhur një ulje e numrit të asamblistëve nga 31 në 27 anëtarë. Kjo ndryshon si rezultat i rishikimit të fundit të dhënave demografike dhe numrit të banorëve, në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara. Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës **1.** Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më 21.07.2025. Pasi nuk pati diskutime, kryesuesi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës e cila u votua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e **2.** Draft buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sqaron për ndryshimin që është bërë për katër pozita të vendeve të punës për shkak të zvogëlimit të numrit të asamblistëve për katër anëtarë të Kuvendit me pak dhe janë shtuar katër pozita për edukatore, sepse ka kërkesa shumë të mëdha në këtë sektor. Besojmë që me këtë numër që e kemi shtu do e bëjmë edhe një çerdhe të re në Komunën e Drenasit, ky ka qenë qëllimi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, kërkoi nga drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Endrit Gllareva sqarim për çështjen e buxhetit. Ne çdo vit kemi ndarë mjete për trotuare, ujëra të zeza, asfaltim për fshatra të caktuara, nuk është realizuar p.sh në Baicë çdo vit kemi ndarë mjete, por nuk ka ndodhur asnjë investim nga buxheti i vitit të kaluar po edhe të viteve të tjera

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ky është një buxhet i takimeve dhe dëgjimeve buxhetore që i kanë kërkuar qytetarët. Ky buxhet i ofrohet Kuvendit kështu si është, jeni të lirë si të doni vëtem keni me bërë barazimin buxhetor, sepse nuk ua pranon sistemi në pip.

Arbër Halialaj, me interesoi të këto nën programet buxhetore me qenë se është afektu për shkaqë të numrit të banorëve ndër 50 mijë edhe në asamble me ineteresoi p.sh. edhe të stafi i projeksonit për vitin 2026, a e ka afektu shumë QKMF-në, në uljen e numrit të stafit apo jo.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, rënia e numrit të banorëve ndër 50 mijë na ka afektu në çdo sektor dikun 780 mijë euro në investime kapitale i kemi më pak.

Kushtrim Bjaraktari zyrtar kryesor financiar, në vitin 2025 i kemi 205 punëtorë, ndërsa për vitin 2026 i kemi 209 punëtorë pavarësisht regjistrimit të popullsisë që neve na ka afektu prapë ne e kemi ruajte edhe e kemi rritë stafin.

Sa i përket projekteve kapitale në vitin e kaluar 3,5 milion euro na ka marr përmbaruesi për kontratë kolektive edhe këtë vit deri me tash 2,8 pra afërsisht jemi 6 milion euro me pak buxhet që i kemi pas të planifikuara të kontraktuara por ka ndërhyrë përmbaruesi .

Hamit Haxhiu, ne jemi që katër vjet në këtë legjislaturë është hera e parë që po dëgjojmë për ndarjen e mjeteve, është dashur paraprakisht me diskutu jo në mbledhjen e fundit, sepse edhe t'i vet ke qenë kryetar i KPF-së, është dashur me na thirr me diskutuar paraprakisht se materialin e kemi të gatshëm një javë përpara dhe me thënë ku po ju merr mendja, ku mundemi me orientua me shumë e ku me pak buxhetin.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, faleminderit për këshillat i nderuar për këtë arsye ne jemi mbledhur këtu në komitet për të diskutuar këto çështje që në të ardhmen me qenë gjërat me të specifikuara. Nuk pati diskutime rreth kësaj pike, kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës e cila u rekomandua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e KPF-së, për në Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 3. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024. Meqë nuk pati diskutime tjera u rekomandua në mënyrë unanime nga anëtarët e KPF-së, për në Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e 4. **Të ndryshme.** Diskutime, vërejtje apo sugjerime nuk pati, kryesuesi e konisderoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 10:35

Procesmbajtësja



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani

Lekturoi



Nikelinda Bujupi